VENDIM
Nr.225, datë 15.4.2005

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.579, DATË 8.9.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE, QË KANË DEPOZITUAR KAPITALET E TYRE PRANË SHOQËRIVE HUAMARRËSE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 13 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 "Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 11 të vendimit nr.579, datë 8.9.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Për rastet kur mandatarkëtimet ekzistojnë në trajtën e kartelave të kompjuterizuara, me të cilat administratorët e pavarur të shoqërive huamarrëse në administrim kanë saktësuar kapitalin e depozituar, detyrimin e mbetur (borxhin) dhe vlerën për kthim, të llogaritur sipas koeficientit të kthimit të shumave për secilin kreditor, një kopje e të cilave i është përcjellë nga administratorët bankës për zbatim, si dhe kur nuk ka ankesa nga kreditorët për treguesit e llogaritur sa më sipër, administratorët autorizojnë bankën për kryerjen e veprimeve për pagesën e kreditorëve, pa qenë e nevojshme kopja e mandatarkëtimit (dublikata) të dhënë nga shoqëria.

Për kreditorë të veçantë, kur banka dyshon në saktësinë dhe vërtetësinë e kapitalit të depozituar, pagesa e kreditorëve pezullohet përkohësisht, duke i kërkuar huadhënësit të paraqesë kopjen e mandatarkëtimit (dublikatën), në trajtën e kartelës së printuar nga administratorët e pavarur të shoqërive huamarrëse në administrim.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano